



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:238607
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528912

KPPP.nr.2176/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit F-SHPED Sh.P.K., me adresë në Dardani, Lekë Dukagjini-Prishtinë, me NRF: 810816431, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.M. avokat nga Ferizaji, kundër debitorit ENERTECH Sh.P.K., me adresë rruga “Nail Hyseni” nr.22 në Prishtinë, me NUI: 811391226, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore “Pro Juris” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.583/2021 të datës 20.09.2021, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 19.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “ENERTECH Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.583/2021 të datës 20.09.2021, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Besnik Aliu, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 78 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.583/2021 të datës 20.09.2021, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave dhe atë: Faturës nr.R33855 të datës 11.05.2021, Faturës nr.R67354 të datës 26.08.2021, Faturës nr.R67700 të datës 27.08.2021, Faturës nr.R63384 të datës 12.08.2021, Faturës nr.R63301 të datës 12.08.2021, Faturës nr.R63266 të datës 12.08.2021, duke e urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'i paguaj kreditorit shumën prej 550.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore 04/L-139 dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077, me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përmbarues nuk është dokument i besueshëm në bazë të LPP-së. Më tej ka theksuar se urdhri përmbarimor nuk i plotëson kërkesat e nenit 38 par.1 dhe par.2 sipas të cilit propozimi për përmbarim duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar, dhe datën e përmbushjes vullnetare të detyrimit, e të cilat i mungojnë këtij urdhri. Ka shtuar se kreditori ka abuzuar me marrëveshjen ndërmjet palëve, duke keqpërdorur vulën për të cilën ka qenë i kontraktuar të bëjë vulosjen e dokumentacioneve për eksport të mallit, në të njëjtën kohë ka bërë edhe vulosjen e faturave. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit ndërsa të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbarimore në tërësi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pabazuara, për arsye se asnjë nga thëniet e tij nuk qëndrojnë, dhe po ashtu nuk ka arritur që me asnjë provë materiale së paku ti vërtetoj të njëjtat, mirëpo qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përmbarimit. Më tej ka theksuar se faturat u janë dorëzuar rregullisht, si dhe vulosja e faturave nga debitori këtë e vërteton edhe mos kontestimi i borxhit. Më tej ka theksuar se debitorit iu ka drejtuar edhe me komunikim të vazhdueshëm ku i njëjti vetëm ka krijuar vonesa lidhur me pagesa, mirëpo borxhin i cili është krijuar nga shërbimi i shpeditacionit nuk e ka kontestuar asnjëherë por vazhdimisht ka kërkuar afat

shtesë për pagesë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të vërtetohet urdhri për përmbarim, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilim të përgjigjes në prapësim në vlerë prej 208 Euro sipas TOAK-së, konkretisht shpërblimin e dyfishuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1273/21 të datës 25.02.2022, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “EnerTech” Sh.P.K., dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.583/21 të datës 20.09.2021 të Përmbaruesit Privat.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.696/23 të datës 31.01.2024 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, duke anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.905/23 të datës 02.10.2023, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për shkak se kjo gjykatë nuk e ka marr në konsideratë faktin se debitori i ka vulosur këto fatura. E ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që të veproj në kuptim të vërejtjeve të saj.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm/faturat- : Faturën nr.R33855 të datës 11.05.2021, Faturën nr.R67354 të datës 26.08.2021, Faturën nr.R67700 të datës 27.08.2021, Faturën nr.R63384 të datës 12.08.2021, Faturën nr.R63301 të datës 12.08.2021, dhe Faturën nr.R63266 të datës 12.08.2021, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet me vulën e debitorit, pra rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 të LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2176/23, me datë 19.03.2024

G j y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.